

Për:	Operatorë Ekonomik: KSF MAJOR SH.A. me adresë në Prizren Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	06.03.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **05.03.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **KSF MAJOR SH.A. me adresë në Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TË KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-1213-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-021-2-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **KSF MAJOR SH.A. me adresë në Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TË KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-1213-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-021-2-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **20.02.2024**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TË KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-1213-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-021-2-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **KSF MAJOR SH.A.** me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TË KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-1213-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-021-2-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **20.02.2024**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **05.03.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Operatori Ekonomik: **KSF MAJOR SH.A.** me adresë në **Prizren**, me datën: **05.03.2024** si palë e pa kënaqur ndaj Njoftimit për kontratë të Autoritetit Kontraktues të datës: **20.02.2024** ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit: **SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TË KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-1213-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-021-2-2-1**, duke supozuar se janë shkelur dispozitat e Nenit 27, 51 dhe 69 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues me datë: **06.03.2024** brenda afatit ligjor ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës ku ka konstatuar si vijon:

Bazuar në legjislacionin primar dhe atë sekondar të prokurimit publik pretendimet tuaja ankimore nuk kanë asnjë bazë ligjore, të gjitha kërkesat tona janë në raport me lëndën dhe qëllimin e kontratës dhe se të njëjtat janë më se ligjore, të gjitha kërkesat e vendosura ndërlidhen me veprimtarinë dhe natyrën e sigurisë fizike.

1. Lidhur me pretendimin tuaj ankimor se Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitën ligjore të Nenit 27 të LPP-së, nuk keni dhënë asnjë argument të bazuar për këtë pretendim ankimor, ju thjesht keni përshkruar se çfarë thuhet në këtë nen, ne si AK konsiderojmë se është i pabazuar pretendimi i juaj, pasi që dosja e tenderit është përpiluar në harmoni të plotë me këtë dispozitë ligjore.
2. Lidhur me pretendimin tuaj se Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitën ligjore të Nenit 59 të LPP-së, ju po ashtu nuk keni dhënë asnjë argument të bazuar për këtë pretendim ankimor, ju thjesht keni përshkruar se çfarë thuhet, ne si AK konsiderojmë se është i pabazuar pretendimi i juaj, pasi që dosja e tenderit është përpiluar në harmoni të plotë me këtë dispozitë ligjore dhe se të gjitha kërkesat janë në raport me qëllimin dhe natyrën e kësaj kontrate. Kjo dosje e tenderit ka qenë edhe gjatë vitit të kaluar me të njëjtat kërkesa, dhe se kemi pasur kompani të interesuara të cilat kanë plotësuar të gjitha kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjen e tenderit, ne gjithnjë jemi në kërkim të një kompanie profesionale e cila ofron shërbime cilësore dhe në harmoni me legjislacionet në fuqi, andaj kërkesat tona janë minimale, kundrejt aktiviteteve të prokurimit të cilat zhvillohen nga Autoritetet tjera Kontraktuese, pasi që natyra e kësaj veprimtarie është e ndjeshme edhe sa i përket shërbimeve edhe sa i përket punëtorëve!.

3. Lidhur me pretendimin tuaj se Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitën ligjore të Nenit 69 të LPP-së lidhur me kërkesën e tenderit nr.3, ju poshto nuk keni dhënë asnjë argument të bazuar për këtë pretendim ankimor, AK ka vendosur kërkesa të cilat janë në harmoni edhe me Ligjin Nr.04/L-004 për Shërbimet private të sigurisë. Të gjitha kompanitë duhet të kryejnë trajnimet e punëtorëve të sigurimit konform Nenit 37 dhe Nenit 38 të po këtij ligji, andaj ju si dhe të gjithë operatorët ekonomik të interesuar mund të keni një Memorandum bashkëpunimi me ndonjë Qendër trajnuese për kryerjen e trajnimeve të rojeve të sigurimit në fushën themelore dhe të specializuar, po ashtu sa i përket kërkesave të tjera si Qendra e kontrollit, licenca për tubime publike dhe ajo e vëzhgimit elektronik, ju njoftojmë se të njëjtat janë obligative dhe të domosdoshme, ne si Autoritet Kontraktues kemi edhe kërkesa nga njësitë përkatëse që të ofrohen këto shërbime, shembull në objektet e pozicionuara në Aneksin 1 tek specifikimet teknike të detyrueshme, punëtori i sigurimit ka për detyrë që gjatë kryerjes së punës të bënë edhe vëzhgimin e kamerave në vendin e tij të punës në ekranin të cilin e posedon, si dhe gjatë eventeve, ceremonive të ndryshme dhe ditëve festive të organizuara ne si Autoritet Kontraktues kërkojmë nga kompania e cila është e angazhuar të sjell punëtor shtesë për sigurimin e këtyre ngjarjeve. Andaj kërkesat janë në harmoni të plotë me Ligjin Nr.04/L-004 për Shërbimet private të sigurisë.
4. Lidhur me pretendimin tuaj se Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitën ligjore të Nenit 69 të LPP-së lidhur me kërkesën e tenderit nr.9 dhe nr.11 për ISO certifikatat, ju po ashtu nuk keni dhënë asnjë argument të bazuar për këtë pretendim ankimor, ashtu siç e kemi cekur të gjitha kërkesat janë në harmoni me legjislacionet në fuqi. Punëtorët e sigurimit duhet të kenë të kryer trajnimin për përdorimin e aparateve për shuarjen e zjarrit dhe ndërmarrjen e të gjitha masave në rast të rrezikut nga zjarri!.

Andaj kërkesa për rishqyrtim e parashtuar nga ana juaj **është e pabazuar**.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>